


## 7. INSTITUCIONET FINANCIARE JOBANKA DHE SHOQËRITË E SIGURIMIT

Institucionet financiare jobanka përfshijnë të gjitha institucionet financiare që nuk përkufizohen “bankë”, sipas ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”. Përveç shoqërive të sigurimit, pjesa tjetër e institucioneve financiare jobanka, zë një peshë pothuaj të papërfillshme në totalin e sistemit. Për këtë arsye, rreziqet e veprimtarisë së këtyre institucioneve, nuk kanë karakter sistematik. Këto institucione përfaqësohen nga institucionet financiare jobanka, të licencuara nga Banka e Shqipërisë dhe të tjera. Gjendja e tyre financiare në fund të tremujorit të katërt është karakterizuar nga një rënie e aktivitetit krahasuar me një tremujor më parë, rënie e kapitalizimit të veprimtarisë dhe një rritje jo e rëndësishme e aktiveve me probleme. Në tregun e produkteve të sigurimit, është realizuar prania e tre kompanive të huaja, nëpërmjet blerjes së shumicës së kapitalit dhe formave të tjera të bashkëpunimit me shoqëritë ekzistuese vendase të sigurimit. Aktivitetet e shoqërive të sigurimeve zënë një pjesë relativisht të vogël të aktiveve të sistemit financiar. Sektori i sigurimeve paraqet një performancë pozitive për sa i përket treguesve të shëndetit si mjaftueshmëria e kapitalit, treguesi i cilësisë së aktiveve dhe eficiencës në përdorimin e kapitalit për 2007. Megjithatë, madhësia e këtij sektori, kufizon ndjeshëm aftësinë e tij për të përballuar financiarisht dëmet financiare që mund të pretendohen, për shkak të vështirësive me të cilat mund të ndeshet pjesa tjetër e sistemit financiar.

Përgjithësisht, institucionet financiare jobanka veprojnë si ndërmjetësues financiarë që nuk pranojnë depozita nga publiku. Në statistikat zyrtare ato klasifikohen si ndërmjetësues të tjerë financiarë, duke përfshirë kompanitë e sigurimit dhe fondet e pensionit. Deri në fund të vitit 2007, vepronin 7 institucione financiare jobanka, të cilat ishin të licencuara nga Banka e Shqipërisë dhe 3 institucione të tjera.


Në tërësi, institucionet financiare jobanka (pa përfshirë shoqëritë e sigurimit) zënë një peshë të papërfillshme në përbërjen e PBB-së, me afërsisht 0.61 për qind për vitin 2007 dhe vetëm 1.83 për qind të aktiveve të sistemit financiar. Ndërkohë, aktivitetet e sektorit bankar zënë peshën kryesore prej 77.6 për qind të PBB-së, ndërsa shoqëritë e sigurimit zënë afërsisht 1.36 për qind të PBB-së. (grafiqet 51 dhe 52).

Grafik 51. Peshat e përbërësve të sistemit financiar ndaj PBB-së në % (2007).




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 52. Peshat specifike të përbërësve të sistemit financiar në %.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 53. Ndryshimi i aktiveve të institucioneve jobanka në %.



Burimi: Banka e Shqipërisë dhe DSF.

Aktivitet e institucioneve financiare jobanka kanë pësuar një rënie me rreth 56 për qind për tremujorin e katërt të vitit 2007, krahasuar me tremujorin paraardhës. Kontributin më të madh në këtë rënie e kanë veprimet me klientët dhe veprimet me arkën, depozitat dhe llogaritë, si zërat kryesorë të aktivitetit të bilancit të tyre. Grafiku 53, paraqet ndryshimin e aktiveve për këto institucione sipas tremujorëve të periudhës 2006-2007.

Kapitalizimi i veprimtarisë për institucionet jobanka, i shprehur si raporti i llogarive të kapitalit me totalin e aktiveve, ka rezultuar afërsisht 44 për qind për tremujorin e katërt të vitit 2007, duke pësuar një rënie me 5 pikë përqindje, krahasuar me tremujorin e tretë të vitit. Për sa i përket cilësisë së aktiveve për tremujorin e katërt të vitit 2007, portofoli i kredive

rezultoi mesatarisht 83 për qind e totalit të aktiveve. Treguesi i kredive me probleme rezultoi 1.17 për qind e totalit të kredive të tyre, duke shënuar një rritje të lehtë me 0.23 pikë përqindje krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2007.

Një tregues tjetër i cilësisë së aktiveve është raporti i aktiveve jofinanciare ndaj totalit të aktiveve. Ky raport për tremujorin e fundit të vitit ka rezultuar afërsisht 2 për qind, duke shënuar një rënie me 3.7 pikë përqindje, krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2007.

Të ardhurat nga interesi përbëjnë burimin kryesor të të ardhurave të këtyre institucioneve; pesha e tyre për tremujorin e fundit të vitit 2007 rezulton afërsisht 82.2 për qind e totalit të të ardhurave. Një tjetër burim të ardhurash janë ato të krijuara nga komisionet, të cilat zënë afërsisht 9.6 për qind të totalit të të ardhurave për tremujorin e fundit të vitit. Vihet re një prirje e ndjeshme rënëse e të ardhurave nga interesat dhe komisionet për tremujorin e katërt të vitit, krahasuar me tremujorin e mëparshëm, konkretisht me 22.3 për qind dhe 74.9 për qind.

Mbështetur në analizën e treguesve të mësipërm, aktiviteti i institucioneve financiare jobanka për tremujorin e fundit të vitit 2007, paraqet një ngadalësim krahasuar me tremujorin e tretë të po këtij viti.

Sektori i sigurimeve ka mundësi të mëdha zhvillimi brenda vendit, ndonëse aktualisht mbetet shumë për të bërë. Në zhvillimin e mëtejshëm të këtij sektori pritet të ndikojë hyrja e tre kompanive të huaja, të cilat nëpërmjet blerjes së kapitalit dhe formave të tjera të bashkëpunimit me shoqëritë e sigurimit ekzistuese, kanë zgjedhur të pozicionohen në tregun shqiptar ku operojnë 11 shoqëri sigurimi. Prej tyre, vetëm 3 shoqëri ofrojnë produkte të sigurimit të jetës.

Aktivitet e sektorit të sigurimeve për tremujorin e tretë<sup>21</sup> të vitit 2007 janë rritur afërsisht me 17 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti


më parë. Sipas disa vlerësimeve, të ardhurat totale nga primet përfaqësojnë 0.6 për qind të PBB-së dhe totali i aktiveve të tyre zë rreth 1.4 për qind të vlerës së PBB-së. Aktivitetet e shoqërive të sigurimit zënë një pjesë relativisht të vogël në totalin e aktiveve të sistemit financiar, rreth 1.8 për qind të tij (tremujori i tretë 2007). Gjatë vitit 2007, vihet re një rritje e të ardhurave nga primet në masën 30.6 për qind në krahasim me vitin 2006, duke e çuar atë në 5.9 miliardë lekë (93 për qind e të cilit përbëhet nga tregu i jojetës). Raporti “dëme ndaj primeve” për vitin 2007, ka pësuar një rënie me 6 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2006 (grafik 54).

Një tregues i rëndësishëm i shëndetit, që pasqyron aftësinë e sektorit për të përballuar humbjet ndaj rreziqeve të mundshme është ai i kapitalizimit të veprimtarisë, i cili matet si raport i kapitalit ndaj totalit të aktiveve. Në këtë mënyrë, kapitalizimi për tremujorin e tretë të vitit 2007 ka rezultuar 52.4 për qind, duke shënuar një rritje prej 5.4 pikë përqindjeje, krahasuar me të njëjtin periudhë të një viti më parë. Krahas treguesit të mësipërm, një tjetër indikator është edhe ai i llogaritur si raport i kapitalit ndaj rezervave teknike, që për tremujorin e tretë të vitit 2007 ka rezultuar 116.5 për qind, duke shënuar një rritje të këtij treguesi me 20.7 pikë përqindjeje. Një element i aftësisë paguese të sistemit janë provigjonet teknike, të cilat për periudhën në fjalë janë rritur me rreth 50 për qind.

Për sa i takon treguesit të kthimit ndaj kapitalit (ROE), ai ka arritur në 19.7 për qind në tremujorin e tretë të vitit 2007, vlerë kjo rreth 2.1 pikë përqindjeje më e lartë sesa një vit më parë.

Në përfundim, sektori i sigurimeve paraqet një performancë pozitive për sa i përket treguesve të shëndetit si kapitalizimi i veprimtarisë, treguesi i cilësisë së aktiveve dhe eficiencës në përdorimin e kapitalit për 2007. Megjithatë madhësia e këtij sektori, kufizon ndjeshëm aftësinë e tij për të përballuar financiarisht dëmet financiare që mund të pretendohen, për shkak të vështirësive me të cilat mund të ndeshet pjesa tjetër e sistemit financiar.

Grafik 54. Raporti dëme/prime në tregun total të sigurimit.



Burimi: AMF (Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare).